

**VENDIM**  
**Nr. 163, datë 18.3.2022**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E  
HARTIMIT TË PROJEKTIT PËR RINDËRTIMIN E INFRASTRUKTURËS  
NDËRTIMORE E TË RRJETIT TË JASHTËM NË IEVP LEZHË DHE CAKTIMIN  
E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e hartimit të projektit për rindërtimin e infrastrukturës ndërtimore e të rrjetit të jashtëm në IEVP Lezhë, në masën 49 000 000 (dyzet e nëntë milionë) lekë pa TVSH.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2022, për Ministrinë e Drejtësisë, në programin buxhetor “Planifikim, menaxhim dhe administrim” 03440, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, shtohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh pa TVSH, për financimin e hartimit të projektit për rindërtimin e infrastrukturës ndërtimore dhe të rrjetit të jashtëm në IEVP Lezhë.

3. Caktimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si njësi zbatuese për financimin e hartimit të projektit për rindërtimin e infrastrukturës ndërtimore dhe të rrjetit të jashtëm në IEVP Lezhë.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**